



HAL
open science

Seksi dhe qyteti: drejt një historie politike të së vërtës

Orgest Azizi

► **To cite this version:**

Orgest Azizi. Seksi dhe qyteti: drejt një historie politike të së vërtës. Michel FOUCAULT, Historia e seksualitetit 1. Vullneti për dije, UET Press, 2010. hal-02094268

HAL Id: hal-02094268

<https://hal.science/hal-02094268>

Submitted on 9 Apr 2019

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

SEKSI DHE QYTETI

Drejt një historie politike të së vërtetës

« Do të doja që kjo histori fragmentare e “shkencës së seksit” të mund të vlente njëkohësisht si skica e një analitike të pushtetit. »

Michel Foucault

Ndër katër librat themelorë të Michel Foucault-së të botuar në të gjallë të autorit (1926-1984) (disa të tjerë janë, të themi, disi më dytësorë, ose mund të shihen si nënpjesë të sistemeve që përbën secili nga ata të parët), vështirë të thuhet se cili pati dhe ka ndikimin më të madh, cili përbën qendrën e kësaj vepre intelektuale madhore, cili është hyrja më e mirë apo jep portretin më të saktë të një mendimi që ishte përherë në lëvizje, zhvendosje, (vet)kërkim, hipoteza dhe rishikime.

Pak e vënë re në botimin e saj të parë më 1961, *Historia e çmendurisë në epokën klasike* u zbulua me zhurmë pak më vonë, duke gjetur vend qëndror në lëvizjet anti-autoritare të viteve '60, ndër aktivistët e shumtë të antipsikiatrisë dhe aty ku çmenduria shihej gjithnjë e më shumë si figurë që implikonte pothuaj tërësinë e institucioneve shoqërore, në kuptimin e gjerë të fjalës. Për një kohë të gjatë, dhe ndoshta për zona të tëra të perceptimit ende sot, Foucault ishte autori subversiv, erudit dhe barok, që në dendurinë e disaqindra faqeve të përndezuara nga flaka elegante e një romantizmi parizian, diti të vërë në pikëpyetje (në mos nën akuzë) tërë racionalitetin perëndimor, duke denoncuar anën e errët të qytetërimit të tij, dhunën racionale teksa ia merr fjalët çmendurisë dhe i mbyll asaj gojën për shekuj me rradhë. Proza sovranë e këtij libri të parë, që i njihte si detyrë vetes të bënte « jo historinë e gjuhës së arsyes, porse arkeologjinë e heshtjes së çmendurisë » së murosur prej saj, sa në qeli, sa në azil, konstelacioni prestigjioz i të përjashtuarve nën hyqmin e të cilëve libri e deklaronte veten (Nietzsche, përherë i pari, Hölderlin, Goya, Nerval, Artaud, Van Gogh...), kritika therrëse e teorisë, praktikave dhe institucionit të psikiatrisë, deri te emrat e tij më të « lavdishëm » (Pinel, Tuke, Esquirol, Orfila, Charcot,...), të gjitha këto bënë që libri të gdhendë qëndrueshëm disa nga tiparet publike të autorit Foucault, si filozofi që, për mirë a për keq (secili sipas shijes), futi dhelprën e çmendurisë në kotecin e arsyes, për të bërë kërdrinë. Vite dhe dekada më pas, madje dhe pas vdekjes, pati (dhe me siguri ka ende) prokurorë të filozofisë, kryesisht në departamentet serioze-shkencor-politike-analitike anglo-amerikane,

që vijonin të hidhnin e prisnin akuzën për irracionalizëm, anarkizëm, niçeizëm të papërmbajtur, tradhëti të iluminizmit, etj. Por nuk është nevoja të zgjatemi tek ana karikaturale e receptimit të veprës, fundja e pashmangshme, si në çdo receptim. E vërtetë është se qysh me këtë libër të parë, Foucault ngjall e mpreh, shpesh dhe acaron pasionet, por ato janë gjithnjë me dy kahe, të mira dhe të liga, aktive dhe reaktive (për të përdorur tipologjinë niçeanë), entuziazëm dhe armiqtësi. *Historia e çmendurisë* është lexuar shumë¹, nga filozofë sigurisht (i pari ndër të cilët dhe nga më seriozët ishte Derrida²), nga historianët e shkencës dhe të psikiatrisë, nga disa psikiatër të sinqertë, nga juristë e sociologë, nga psikanalistë e punonjës socialë, nga të sëmurë mendorë e familjet e tyre, nga studentë e militantë, etj. Në fushën universitare dhe kërkimore, libri është bërë shkas për kryerjen e një sërë hulumtimesh, anketash, rishikimesh, hapje kantieresh e zbulime arkivash, rishkrime e rilexime të historisë së dijes psikiatrike. Sot, 50 vjet më pas, prurjet metodologjike e konceptuale të tij janë integruar në ligjërimin e përgjithshëm, por takimi me veprën mbetet kalim i detyruar për përjetimin e impaktit heuristik dhe tronditjen e opinionëve të pranuar, si një etapë në edukimin e ndjeshmërive. *Historia e çmendurisë*, sot, është më tepër një veprë morale. Po aq përbën akt moral leximi i saj.

Me modalitete të ndryshme, e njëjta ecuri mund të përshkruhet për dy veprat pasuese, që nuk ekzistojnë ende në shqip. *Les mots et les choses. Une archéologie des sciences humaines* (« Fjalët dhe qeniet. Një arkeologji e shkencave humane », 1966), u bë menjëherë një *best-seller* filozofik, gjerësisht edhe saje një keqkuptimi reduktues. Tamburi i mediave e hodhi beftas Foucault-në nën tërë dritat e skenës, duke e paraqitur tanimë si një nga yjet (disa thanë papën) e strukturalizmit, si riinterpretuesin brilant të dijes perëndimore dhe teoricienin provokues të « vdekjes së njeriut ». Për ata që nuk e dinë se përse bëhet fjalë, më mirë ta lemë shprehjen, tashmë të lodhur pas aq përsëritjesh, me tërë enigmën e saj kërcënuese. Peizazhi këtu është në njëfarë mënyrë krejt i ndryshëm nga i pari : i ftohtë, epistemologjik, vendin e

¹ Është po ashtu libri i tij i parë i përkthyer (nga Leka Toto) dhe botuar në shqip, me titullin *Histoire e marrëzisë në epokën klasike* (Toena, Tiranë 2003), në kuadrin e programit të « Librave për një shoqëri të hapur ». Megjithë ardhjen nga lista të hartuara gjetiu, fakti i përzgjedhjes së këtij libri, që është dhe më voluminozi i Foucault-së, për t'u botuar i pari (dhe për një kohë të gjatë, i vetmi) flet për qëndrueshmërinë e perceptimit të Foucault-së si autor kryesisht i këtij libri. Se sa është lexuar libri në Shqipëri qysh nga ky botim, asnjë e dhënë apo gjurmë e dukshme publike nuk na lejon të shprehemi.

² Fillimisht në një konferencë të mbajtur, në prani të Foucault-së, më 1963, me titullin « *Cogito et histoire de la folie* », të rimarrë më pas në vëllimin *L'écriture et la différence*. Foucault do të japë një përgjigje të gjatë dhe disi agresive rreth dhjetë vjet më pas, më 1972, me rastin e botimit të tekstit të Derrida-së në një revistë japoneze. Kjo përplasje i preu marrëdhëniet personale mes dy autorëve. Derrida gjithsesi i rikthehet dosjes dhe librit, nga një pikëpamje tjetër, lidhur me vendin e psikanalizës dhe Freud-it në *Historinë e çmendurisë*, por pas vdekjes së autorit : « Être juste avec Freud », në librin *Résistances. De la psychanalyse* (1992). Dosjen e plotë të këtij episodi, si dhe analizën e rëndësisë filozofike të tij, do t'ia paraqesim së shpejti lexuesit shqipfolës.

arkivave dhe popullatës së tyre e zënë traktatet (që nuk mungonin as tek i pari, por ishin aty në funksion të arkivave). Foucault përshkruan ecurinë e vetvetishme të disa dijeve moderne perëndimore (ekonomi, gjuhësi, biologji : « njohjen e qenieve të gjalla, njohjen e ligjeve të gjuhës, njohjen e fakteve ekonomike »), eksperimenton nocionet e « epistemës », « a priorisë historike », pavetëdijes pozitive, njësive ligjërimore, thyerjes epistemologjike ; rimerr, nga Bachelard dhe Canguilhem, idenë e pragut epistemologjik ; shkurt pra, bën histori konceptesh dhe riartikulon prerjet e mëdha periodike të historisë së dijeve përmes një studimi të « praktikave ligjërimore » dhe rregullave të transformimit të tyre. « Ne, që ushqejmë pasionin e konceptit... ». Pathosi i librit të parë duket disi larg, por efekti, në zona të tjera, është po ai : objekte të reja i ofrohen mendimit dhe kërkimit, e kaluara më e afërt tëhuajëzohet për trashëgimtarët e fjetur, epistemologjia historike bëhet variant i etnologjisë së mendësive dhe kodeve të percetimit, dhe shumë e respektueshmja (si pasojë e moshës mendore të disiplinës, dhe jo vetëm e moshës natyrore të atyre që e ushtrojnë) « histori e ideve » detyrohet të luajë vendit, të dalë nga shinat, të rishikojë një pjesë të mirë të rezultateve dhe pothuaj tërësinë e postulateve që e udhëheqin. Pothuaj 50 vjet më pas, po aq lënda e këtij libri është përthithur në ligjërimin e përgjithshëm. Historianët vijojnë të bëjnë punën e tyre. Disa gjëra janë riparë, disa lexime saktësuar, disa kufij janë zhvendosur ose vënë në pikëpyetje, por me ndërtimin e tij kristalin, virtuoze të analizës, madhështinë e stilit, libri mbetet përherë një nga tablotë më pasionante të kulturës perëndimore, një paraqitje pothuaj antropologjike e pasqyrimin të një kulture nga vetvetja, përmes orvatjes për të njohur e futur në ligjërim aspektet themelore të kushtit njerëzor : gjuhën, jetën, punën.

Profili i autorit nis të sendërtohet ndërkaq : një specialist, erudit dhe novator, gjysma filozof dhe gjysma historian i kulturës dhe ideve perëndimore moderne, që vozit diku mes shekujve XVII-XIX. Disa figura nisin të bëhen po ashtu familjare : arkivat, fillesat e shkencave të njeriut, historia e psikologjisë dhe mjekësisë klinike, të përjashtuarit dhe marginalizma të tjera, disa jetë të heshtura (në mos po të heshtuara : « *réduites en silence* ») të ripërtërira nga afshi i stilit dhe shkëlqimi i talentit. Autori njihet me plot gojën si intelektual, madje, qysh nga viti 1970, në moshë goxha të re për një post të tillë, mban dhe katedrën e « Historisë së sistemeve të mendimit » në Collège de France, shtëpia më prestigjioze e dijes franceze, ku patën ligjëruar Renan dhe Michelet, Valéry dhe Bergson, Durkheim dhe Lévi-Strauss, Marc Bloch, Lucien Febvre dhe Fernand Braudel (etërit e revolucionit historiografik të « shkollës »

së *Analeve*), Georges Dumézil (strukturalisti i vërtetë i analizës së miteve indo-europiane) dhe Émile Benveniste, Merleau-Ponty dhe ish-mentori Jean Hyppolite³.

« Vullneti për dije » : pushtete, dije, norma

« Sisteme të mendimit » emërton pikërisht atë nivel të ndërmjetëm, mes shkencës dhe opinionit, që përcakton terrenin e « arkeologjisë së dijeve » ku do të vendoset hulumtimi i Foucault-së. Në përmbledhjen e punimeve dhe projektit kërkimor që pati paraqitur si kandidaturë për katedrën në fjalë, Foucault e paraqet këtë nivel specifik të arkeologjisë si më poshtë : « Mes një tradite refleksive të ndërgjegjes së kulluar dhe empirizmit të ndijimit, filozofia i kishte njohur vetes si detyrë jo aq gjetjen e gjenezës, as lidhjes, madje as të sipërfaqes së kontaktit mes tyre, por të një përmase të tretë : atë të perceptimit dhe trupit (Foucault i referohet më së shumti veprës së Merleau-Ponty-së – O. A.). Historia e mendimit kërkon ndoshta sot një modifikim të së njëjtës natyrë ; mes shkencave të formuara tashmë (historia e të cilave bëhet shpesh) dhe dukurive të opinionit (që dinë t'i trajtojnë historianët), do të duhej të ndërmerrej një histori e sistemeve të mendimit. Mirëpo, kjo nxjerrje në dritë e veçantësisë së dijes, përveçse përvijon një nivel specifik të analizës historike të anashkaluar deri tani, ka mundësi të na shtyjë të rishqyrtojmë vetë dijen, kushtet e saj dhe statusin e subjektit njohës.⁴ » « Nivel arkeologjik », « dije » (në dallim nga shkenca), « praktika ligjërimore » (në dallim nga historia e ideve), janë emërtime të ndryshme për të njëjtën kategori, të njëjtin kantier, që popullohet nga figura të tjera specifike (ligjërim : *discours*, kumte : *énoncés*, dhe jo autorë apo vepra) dhe organizohet sipas ecurish të tjera (rregulla transformimi, mungesë e subjektit themeltar, thyerje epistemologjike, materializëm i ngjarjeve, etj.). Ky nivel i ndërmjetëm shërben si prerje e tërthortë në ontologjinë historiko-shoqërore, si terreni ku vijnë e takohen dy polet e ekzistencës efektive historike të njeriut : *veprimi* dhe *mendimi*, forca dhe ideja. Specifika e metodës së Foucault-së është pikërisht shpalosja, përvijimi dhe qëndrimi në një nivel të tillë, që lejon të zbulohet karakteri thelbësor i pikëtakimit të dy poleve, imanenca e ndërsjellë e zhvillimit të dijeve dhe e raportit të forcave. Këtë imanencë, apo njërrafshtësi, në fillimet e mësimdhënies në Collège de France, Foucault do ta përcaktojë përmes dy sintagmash kryesisht : « rendi i ligjërimit » (*l'ordre du discours*)

³ Shih, faqet e fundit të leksionit përurues së katedrës në fjalë, « Rendi i ligjërimit », përkthyer nga Persida Asllani në, M. Foucault, *Pushteti dhe Dija. Katër sprova*, bot. ISP-Dita 2000, Kolana e mendimit politik, Tiranë 2009.

⁴ M. Foucault, « Titres et travaux » (1969), në *Dits et écrits*, Paris, Gallimard 1994, vëll I, fq. 846.

dhe vullnet për dije (*volonté de savoir*). Përkthimi i *ordre* me «rend» nuk e shterr fatkeqësisht kuptimin e fjalës në shqip. *Ordre* do të thotë sigurisht ‘rend’, por edhe ‘urdhër’ (fundja, «urdhër» nuk është veçse një transkriptim në fonetikë shqipe i së njëjtës rrënjë); dhe «rendi i ligjërimit» mund të lexohet si: a) renditje apo strukturë e renditur e ligjërimit; b) si vënie e ligjërimit nën rend apo ruajtje e rendit në të e përmes tij (*police des discours*); c) si identifikimi i efekteve të ndryshme të urdhërimit që përcillen përmes ligjërimeve; d) por po ashtu si përcaktimi i një rendi të veçantë të analizës, që është ai i ligjërimeve (siç themi, për shembull, se njeriu i përket rendit të gjitarëve)⁵. Dhe «vullneti për dije», titull edhe i librit tonë, do të jetë fillimisht titulli i ciklit të parë të leksioneve të mbajtura në Collège de France (1970-1971), togfjalësh palimpsest, niçean sigurisht, ku takohen apo dëgjohen «vullneti për fuqi» dhe «dija gazmore» (apo e hareshme: *fröhliche Wissenschaft*; në frëngjisht: *gai savoir*).

Pikërisht, në leksionet që i kushton shqyrtimit të këtij koncepti të ri, duke iu larguar një formulimi të parë, që është ai i Aristotelit (raport mes njohjes, së vërtetës dhe kënaqësisë e ndijimit), referenca qëndrore do të jetë ajo niçeane, që e paraqet njohjen si një shpikje luftarake, mjet dhe objekt vullnetesh, fuqish, instinktesh, rezultat i kompromisit dhe urrejtjes, pakt i brishtë dhe përherë i tradhëtuar, shërbestare dhe e interesuar: «Një model i tillë i njohjes si thellësisht e interesuar, ku njohja prodhohet si ngjarje e vullnetit dhe ku efektet e së vërtetës përcaktohen përmes një falsifikimi paraprak, është, pa dyshim, diametralisht i kundërt me postulatet e metafizikës klasike. Ky ishte dhe modeli që u përdor gjatë hulumtimeve të këtij viti, duke ia zbatuar një serie shembujsh, të huazuar nga historia e institucioneve arkaike greke, dhe që i takojnë të gjithë fushës së drejtësisë.⁶»

«Fushës së drejtësisë». Jo më kot. Fillimisht, kushdo mund të vërë re se, në përgjithësi, fusha e drejtësisë ngërthen në vete, në artikullimin e saj konkret, në pozitivitetin e ushtrimit të saj, dy anët e mësipërme: një pushtet, për të ndëshkuar, sanksionuar, detyruar, ndaluar e lejuar, për të ravijëzuar format e pranueshme të qenies shoqërore; por dhe një dije, që përbëhet nga tërësia e elementëve dhe procedurave pozitive të vëna në punë për prodhimin

⁵ «Mund të pyesim atëherë se ç’është *Arkeologjia*, nëse nuk është as teori e as metodologji. Do të përgjigjesha ndoshta duke thënë se ka të bëjë, në njëfarë mënyre, me dëftimin e një objekti: një orvatje për të përvijuar nivelin ku më duhej të vendosesha për t’i bërë të dukshme ato objekte që pata manipuluar për një kohë të gjatë, pa e ditur as vetë nëse ekzistonin si të tillë, e pra dhe pa mundur t’i emërtoja», «Entretien avec Michel Foucault» (1971), në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. I, fq. 157. «Arkeologjia» e përmendur është njëkohësisht objekti apo niveli që orvatet të përkufizojë Foucault, si dhe libri ku materializohet kjo orvatje, *L’archéologie du savoir* («Arkeologjia e dijes», Paris 1969).

⁶ M. Foucault, «La volonté de savoir» (1971), në *Résumé des cours 1970-1982*, Paris, Julliard, 1989, fq. 14-15 (rimarrë në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. II, fq. 240-244).

e gjykimit : hulumtime, hetime, caktim i së vërtetës, status dhe praktikë e provës, peshim i aktit dhe përkthim i domethënies së tij në vlerë shoqërore, objektiv i dënimit, etj. Si shkencë-dhe-pushtet mbi aktet, « fusha e drejtësisë » shfaqet si terreni i privilegjuar i formave të ndryshme të mishërimit (apo sendërtimit, « objektivizimit » do të thoshte Hegeli) të vullnetit për dije. Mirëpo, në kohët moderne – në atë hark kohor që është dhe objekti kryesor i deriatëhershëm i studimeve të Foucault-së, shekujt XVIII-XIX, që përkojnë dhe me lindjen e shkencave të njeriut (ku njeriu *ndërtohet* si objekt i dijeve dhe shkencave të ndryshme), me lindjen e mjekësisë klinike dhe të psikiatrisë – sendërtimi i vullnetit për dije rreth « fushës së drejtësisë » merr disa tipare të veçanta. Dispozitivi i shkencave të njeriut, dispozitivi mediko-psikiatrik dhe ai i drejtësisë penale, lidhen së bashku në një qerthull tresh, ku secila nga nyjet ushqen të tjerat. Funkcionimi i drejtësisë penale rrëshqet përherë e më shumë, nga një gjykim dhe dënim i aktit të paligjshëm, në shqyrtim dhe marrje në ngarkim të njeriut akt-bërës, si personalitet, si histori, si devijim, si anormal. Kalohet, filozofikisht, nga shqyrtimi i aktit (dhe dihet se akti dhe arsyet e tij janë pika më enigmatike që has çdo filozofi) te ndërtimi i një natyre, nga *gjykimi* i krimit, te *njohja* e kriminelit. Përherë e më ndjeshëm, dispozitivi i penaltetit funksionon jo më si instancë ndëshkimi, por si makinë riedukimi, korrigjimi, normimi, adaptimi, disiplinimi, etj. Ekspertiza mediko-psikiatrike (e përdorur fillimisht për të përcaktuar nëse subjekti ishte apo jo përgjegjës për aktin e kryer, nëse « trajtimi » i tij i përkiste drejtësisë apo mjekësisë, burgut apo spitalit) nis të bëhet pjesë përbërëse e çdo procesi gjykimi penal, duke i imponuar së tërës racionalitetin e vet. Shoqëria dhe format e ndryshme të pushtetit në të funksionojnë gjithnjë e më pak në raport me *ligjin*, dhe përherë e më shumë në raport me *normën*. Dhe natyrshëm atëherë, një praktikë penale që funksionon sipas modelit të normës, do të gjejë mbështetjen dhe justifikimin e saj te dijet e kësaj norme : qoftë si dallim i normales dhe patologjikes (mjekësi, psikiatri, etj.), qoftë si dallim mes normales dhe anormales : antropologji, kriminologji, pedagogji, sociologji, seksologji, etj. Shihet se si, përtej objektivitetit të pandehur të « shkencave humane », është në veprim një vullnet i lig për të ndëshkuar, një vullnet për ta kapluar « njeriun » (të parë si tërësi reale dhe virtuale sjelljesh), njëherësh dhe në mënyrë të dyfishtë, *si objekt të njohjes dhe objekt të dënimit, të njohjes përmes dënimit dhe të dënimit përmes njohjes*. Në përgjithësi pra, si objekt të ndërhyrjes dhe administrimit.

Efektshmërinë e kësaj makinerie të trefishtë, njohëse, ndëshkuese dhe mjekuese, modelin analogjik të funksionimit të saj në të tëra nivelet e shoqërisë, peshën strukturuse që ka ajo në formësimin e praktikave dhe ligjërimeve, Foucault do t'i përshkruajë me një emër të

përgjithshëm : « disiplinim ». Lindja e shoqërisë moderne shfaqet si lindje e një shoqërie disiplinore dhe, në njëfarë mënyre, gjeneza e modernitetit përkon me rënien nga idealet e Iluminizimit në praktikat e disiplinimit, ose më saktë akoma, me sendërtimin e këtyre idealeve në formën e këtyre praktikave. Burgu si institucion dhe mënyra e tij e funksionimit, me futjen e tij në qendër të sistemit penal në fillim të shek. XIX, duke inauguruar kështu një ekonomi të re të ndëshkimeve, një teknologji të re të trajtimit shoqëror të trupit, do të shërbejë si model analogjik i shpërhapjes së kësaj « ortopedie sociale ». Nga klasat te kazemat, duke kaluar nga punishtet, uzinat, spitalet, azilet, kolegjet, fjetoret, etj., përfshirë dhe organizimin e ri të hapësirës familjare dhe detyrat e saj, nuk është çudi që « burgu t'u ngjajë të tëra këtyre institucioneve kur të gjitha ato ngjajnë si burgje⁷ ». Në të tëra, strukturimi i renditur i sjelljeve, disiplinimi i synuar përmes një përkujdesjeje dhe vëzhgimi individual(izues), mbështeten te mekanizma të ndryshëm dijeje dhe shërbejnë, nga ana e tyre, si instrumente dhe terren për shtimin e saj : vëzhgime, statistika, regjistra, përshkrime, pyetësorë, egzaminime, grafikë, raporte, evidenca, etj. Proza monotone e jetës së përditshme merr tanimë një status të privilegjuar, duke u bërë objekt i interesit të dyfishtë të pushtetit dhe shkencës.

E tillë është gjendja e hulumtimeve të Foucault-së në fillimet e viteve '70, siç e tregojnë dhe titujt e cikleve vjetorë të leksioneve në Collège de France : *Vullneti për dije* (cikli i parë, 1970-71) do të pasohet nga *Teori dhe institucione penale* (1971-72), *Shoqëria ndëshkimore* (1972-73), *Pushteti psikiatrik* (1973-74), *Anormalët* (1974-75). Më 1975, pas përvojës së një angazhimi të gjatë mbi çështjen e burgjeve, duke bashkëthemeluar, më 1971, Grupin e Informacionit mbi Burgjet (*Groupe d'Information sur les Prisons*, GIP), një strukturë model e gërshetimit të luftërave sociale me ndërhyrjen e asaj figure të re të intelektualit që do të përpiqet ta teorizojë nën emërtimin e « intelektualit specifik⁸ », Foucault do të botojë librin që përmbledh rezultatet e kësaj pune të dyfishtë, mes angazhimit politik në terren dhe kërkimeve në pluhurin e arkivave : « Disiplinë dhe ndëshkim. Lindja e burgut » (*Surveiller et punir. Naissance de la prison*, 1975). Libër që përbëri një tronditje të madhe, sa në fushën e filozofisë, aq dhe në atë të historisë dhe teorisë së penaltetit, dhe njohu një përhapje ndërkombëtare pothuaj të menjëhershme, duke u përkthyer shumë shpejt në mbi njëzet gjuhë. Si në rastin e çmendurisë së librit të parë, Foucault fuste në fushën e qashtë të filozofisë një

⁷ M. Foucault, *Disiplinë dhe ndëshkim. Lindja e burgut*, përkth. shqip O. Azizi, bot. Odeon, Tiranë 2010, fq. 225 ; për sa ma lart, *po aty*, Kapitulli i parë, « Trupi i të dënuarve ».

⁸ Teksti klasik i këtij teorizimi është një dialog me Gilles Deleuze më 1972, botuar me titullin « Les intellectuels et le pouvoir » (« Intelektualët dhe pushteti »), fillimisht në revistën *L'Arc*, n° 49, fq. 3-10 dhe rimarrë më pas në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. II, fq. 306-315. Intelektuali specifik synon të dallohet, në konfigurimin e ri të funksionimit të pushtet-dijeve në shoqëritë moderne, nga intelektual i universal, i mishëruar në traditën franceze nga Voltaire te Sartre.

objekt të ri dhe skandaloz, të turpshëm e të fëlliqur. Që nga Platoni e deri te analizat e vona të Paul Ricoeur-it⁹, filozofia është marrë vetëm me diskutimin e justifikimin etiko-filozofik të dënimit të drejtë. Foucault përqëndrohej, përkundrazi, te praktika konkrete e dënimeve (që përfshin dhe format e ndryshme të teorizimit të saj), duke aktualizuar kështu projektin niçean të një historie të mizorisë dhe të ndëshkimit si e vetmja gjenealogji e mirëfilltë e moralit.

Ky është pra dhe profili i tretë sundues i autorit Foucault : pas denoncuesit barok të përjashtimit të dhunshëm të çmendurisë nga fusha e racionalitetit perëndimor, pas arkeologut erudit të kodeve organizuese të dijes moderne dhe përvijuesit të pavetëdijes së kulturës europiane, figura e intelektualit të angazhuar dhe subversiv, radikal politik i cili, në fushën dhe objektet e veta të kërkimit, denoncon format më të imëta të ushtrimit të pushtetit.

Dispozitivi i seksualitetit

« Nuk dua të bëj sociologjinë e një ndalimi, porse historinë politike të një procedure vërtetësimi »

Michel Foucault

Libri ynë, *Vullneti për dije*, që inauguron qysh në kryetitull një seri kërkimesh të ardhme mbi një « histori të seksualitetit », dhe në raport me të cilën synon të vlejë si përvijim paraprak i fushës së kërkimit dhe parashtrim metodologjik, hartohet pikërisht në këtë moment teorik dhe do të botohet vetëm një vit pas librit mbi burgjet (ose, sipas një shprehjeje të bukur të Philippe Artières, « librit të jetëve fajtores ») : më 1976 pra. Mirëpo, pse seksualiteti ? Si kalohet nga pushteti te seksi ? Si dhe nga vjen ky objekt i ri i interesit teoriko-historik të Foucault-së ?

⁹ Shih, për shembull, esenë, « Mbi të drejtën. Forca dhe kufijtë e drejtësisë », të Paul Ricoeur, ku autori shqyrton atë që e quan « skandal intelektual », domethënë « vuajtjen që i jepet përmes ndëshkimit fajtorit të dënuar, vuajtje të cilën institucioni gjyqësor duket sikur ia mbishton së jashtmi asaj që ka pësuar paraprakisht viktima e shkeljes, e dëmit apo e ndonjë cënimi tjetër », duke rindërtuar historinë e « dështimit të përpjekjeve më të elaboruara për të dhënë një justifikim racional të dhunës ndëshkuese » përgjatë historisë së filozofisë, që nga Platoni e Aristoteli, deri te Kanti e Hegeli. Paul Ricoeur, *Konflikti, drejtësia, politika*, përkth. shqip O. Azizi, bot. ISP-Dita 2000, Kolana e mendimit politik, Tiranë 2011 (në botim).

Tashmë te « Rendi i ligjërimimit » (1970), Foucault e kishte përmendur historinë e seksualitetit si një nga pistat e kërkimit në të ardhmen, bashkë me të tjera si : historinë e dijeve biologjike mbi trashëgimninë, atë të ekzegjës biblike, formimin dhe evoluimin e koncepteve psikiatrike etj. Në parathënien e shkruar për botimin gjermanisht të librit (1977), Foucault na e bën më të qartë shfaqjen e pistës seksuale : « Lexuesit që, duke lexuar këtë libër, shpresojnë të mësojnë se si kanë dashuruar njerëzit ndër shekuj, apo se si u ka qenë ndaluar një gjë e tillë (çështje pa dyshim shumë serioze, e rëndësishme dhe e vështirë), kam frikë se do mbeten të zhgënjyer. Synimi im nuk ishte të shkruaja historinë e sjelljeve seksuale në shoqëritë perëndimore, por të trajtoja një çështje më të qetë dhe më të kufizuar : cila është ecuria që i bëri këto sjellje objekte të dijes ? Me ç'mënyra dhe për ç'arsye u pat' organizuar kjo fushë e veçantë dijesh, për emërtimin e së cilës përdorim termin relativisht të vonët të "seksualitetit" ?¹⁰ » Shihet pra, se seksualiteti, që në fakt duhet të përdoret këtu përherë me thonjëza, paraqitet si terreni tjetër i privilegjuar i sendërtimit të vullnetit për dije, si fushë e artikulimit të një dijeje, që është rezultat i investimi të një vullneti, dhe pra i ushtrimit të një pushteti dhe artikulimit të një raporti forcash. « Terren », « fushë artikulimi », « rezultat », duhen marrë këtu seriozisht. Pozita e Foucault-së është këtu nominaliste, ose konstruktiviste, më shumë se kurrë. Në njërën nga intervistat e dhëna pas botimit të librit¹¹, ai shpjegon gjenezën e tij dhe evolucionin e qëndrimit teorik. Foucault pat' kaluar kështu nga një konceptim i parë i *Vullnetit për dije* si një histori ku « seksualiteti » mësyn, mbulon, bllokon dhe fshesh seksin, histori e artikuluar pra sipas një skeme të vjetër të funksionimit të pushtetit (si pushtet për të ndaluar, si funksionim negativ), te një konceptim i ri ku seks/seksualitet i përkasin të njëjtës fabrikë ligjërimore. Pushteti, kështu, del si ndërtim i realiteteve mbi dhe nëpërmjet të cilave ushtrohet.

Përmendëm pak më lart se lindja e « njeriut » si objekt i dijes e ofronte njëkohësisht atë si objekt të ndërhyrjes dhe të pushtetit. Nuk ka mëtim për kapjen shkencore të sjelljeve të njeriut dhe natyrës së tij që të mos territorializohet në mëtim për administrimin e kësaj sjelljeje dhe kontrollin e saj. Gjë që, në mos nga tjetër, shihet qartë sot nga zhvillimi pothuaj i pakufishëm i « shkencave » menaxheriale, të marketingut apo të komunikimit, të tëra njëherësh instrumente të qeverisjes së sjelljeve sociale dhe individuale. Mirëpo, njeriu si objekt i dijes, ka veçantinë të paraqitet si subjekt. Njeriu është njëherësh objekt dhe subjekt i

¹⁰ M. Foucault, « Séxualité et vérité », në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. III, fq. 136-137 (botuar fillimisht me titullin « Sexualität und Wahrheit », në M. Foucault, *Der Wille zum Wissen*, Frankfurt, Suhrkamp Verlag, 1977, fq. 7-8)

¹¹ « Les rapports de pouvoir passent à l'intérieur des corps », botuar fillimisht në *Quinzaine littéraire*, n° 247, janar 1977 ; rimarrë në *Dits et écrits*, vep. cit. vëll. III, fq. 228.

dijes, ose më saktësisht : njeriu është një subjekt, i cili, subjektin e vet e merr si objekt të dijes. Ky status i dyfishtë është korrelativ dhe njeriu jetohet si subjekt në çastin e ndërtimit të tij si objekt i dijes (dhe pushteteve). Por, kjo formë subjektive e të qenit objekt do të thotë se dija dhe pushtetet e synojnë njeriun, arrijnë ta depërtojnë atë, ushtrohen dhe formësohen rreth tij, përmes raportit të njeriut *me veten*. Pushteti *ushtrohet* mbi njeriun si objekt (s’duhet të harrojmë se « njeriu », këtu, nuk ka konsistencë tjetër për Foucault-në veçse si tërësia e sjelljeve reale dhe të mundshme të tij dhe e ndërveprimit të tyre me të tjerët dhe mjedisin rrethues) vetëm përsa arrin ta *prodhojë* atë si subjekt. Nëse, sipas analizës niçeane, penaliteti e prodhonte (dhe sundonte) njeriun-subjekt përmes premtimit, ndjenjës së fajësisë dhe brerjes së ndërgjegjës, seksualiteti e prodhon atë përmes shtysës për vetshqyrtim dhe vetanalizë. Analiza e Foucault-së tregon kështu se, raporti me veten, në këtë rast, kalon përmes instancës së tjetrit, që është ajo e dijes dhe ajo e pushtetit. Kundër hipotezës së përhapur në ato kohëra të revolucionit seksual dhe të liberalizimit të zakoneve, sipas së cilës seksi ka qenë gjithmonë (e sidomos në epokën borgjezo-viktoriane, në mos në Europën e krishterë) i shtypur nga pushteti, kundër hipotezës së një seksualiteti fillestar të çlirët që ka rënë nën shtypje e që duhet ri-çliruar, kundër mendimit të raporteve seks-pushtet sipas modelit negativ të shtypjes (*répression*), Foucault përdor një analizë pozitive të pushtetit, të parë para së gjithash si prodhimtar, si nxitës, si shtues e riprodhues. ‘Pozitiv’ nuk ka këtu asnjë kuptim moral, por thjesht teknologjik e material. Pushtet-dijet, ato që depërtojnë edhe më në thellësi, nuk mund të formësohen e të ushtrohen pa prodhuar njeherësh edhe objektin e tyre si objekt të dyfishtë dijeje dhe pushteti.

« I shtypur seksi ? », pyet Foucault. « Më shumë sesa të dhënë pas shtypjes (*répression*) së seksit, do ta shihja shoqërinë tonë si të dhënë pas shprehjes (*expression*) pafund të tij¹² ». Në të vërtetë, qysh nga shekulli XVIII, një armatë e tërë mjekësh, higjienistësh, pedagogësh, filantropësh, gjyqtarësh, psikologësh, moralistësh, reformatorësh etj., janë përkulur drejt tij për ta zhbiruar, analizuar, klasifikuar, kuptuar, kanalizuar atë. Një teknologji e pafundme ekzaminimi, rrëfimi (*confession* ne fillesat e saj kishtare, *aveu*, më pas, në formë të përgjithësuar shoqërore), tregimi, qëmtimi është shpikur rreth « misterit » të

¹² M. F., « L’Occident et la vérité du sexe », në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. III, fq. 105 ; dhe, po aty : « zhbirimi i raportit të ligjërit të vërtetë me kënaqësinë e seksit ka qenë një nga shqetësimet më të vazhdueshme të shoqërive perëndimore, dhe kjo për shekuj të tërë »; më tej : « po sikur pushteti të mos ketë për funksion të thotë vetëm « jo », të ndalojë e të censurojë, por të lidhë, në një spirale të pafundme, shtrëngesën, kënaqësinë dhe vërtetësinë ? » (fq. 103). Kështu kryhet lidhja mes dy poleve të analizuara nga Foucault : një « erotikë e së vërtetës » dhe një « politikë e seksit ». Lidhur me kritikën e konceptit të shtypjes/ndrydhjes (*repression*), sa në teorinë politike, aq dhe në fushën e seksualitetit, shih « Leksionet e 7 dhe 14 janarit », përkth. shqip, O. Azizi, në Michel Foucault, *Pushteti dhe dija. Katër sprova*, vep. cit.

seksit, teknologji që do të kolonizojë më pas fusha të tëra të ekzistencës shoqërore. Me rradhë ose njëherësh, seksi i fëmijëve, ai i grave, ai i deviantëve të çdo lloji, seksi i bashkëshortëve por dhe ai i beqarëve, seksi i borgjezisë për arsye trashëgimnie por dhe ai i proletariatit për arsye force dhe higjiene, seksi i të gjithëve për arsye fetare, janë bërë pareshtur objekte merakut, shqetësimi, kontrolli, parashikimi, diagnoze etj. Dhe shihet qartë se sa i privilegjuar është seksi si fushë, në mënyrë që kjo sipërmarrje të kryhet në mënyrë të dyanshme, nga jashtë subjektit, dhe nga vetë ai në raport me veten. Mënyra më e mirë për t'i përbrendësuar normat dhe shtigjet e riprodhimit të dijeve si dhe shinat e depërtimit të pushtetit. Seksi universal, ngaqë kushdo është i pajisur ; individual dhe kolektiv, ngase dukuritë e tij prekin sa bartësin aq dhe grupin apo popullatën në tërësi ; i çdo moshe, grupi e gjinie ; seksi, po ashtu, në pikëprerjen e psikikës dhe trupores, realitet bio-anatomik por dhe strukturim i identitetit psikologjik, sa çështje mjekësore aq dhe morale. Seksi, bartësi i mundshëm i të gjitha sëmundjeve dhe siguria e të gjitha identiteteve, njëkohësisht barrë dhe sjellje, trashëgimni dhe përdorim. Terreni më intensiv dhe i ekspozuar i patologjive, devijimeve, anormalitetit, paqendrueshmërisë. « Ka qytetërime që kanë patur dhe kultivuar atë që do të mund ta quanim një *ars erotica* – thotë Foucault –, por ky i yni ishte i vetmi që shpiku një *scientia sexualis* ».

Trekëndëshi qerthullor (nëse mund të themi) i indentifikuar më sipër funksionon këtu edhe më mirë : *njohja*, si prodhim dhe detyrim për të prodhuar ligjërimi të ngarkuar me vlera vërtetësie, *mjekimi*, dhe madje parandalimi i trazimeve të lidhura me seksin (dmth., pothuajse të gjitha) dhe *pushteti* si qeverisje, përkulje, drejtim dhe administrueshmëri e përgjithshme e sjelljeve : të treja këto në nivel individual dhe kolektiv. Dispozitivi i seksualitetit, përmes universalitetit të vet, përbrendësimit të nxitjes për të vërtetën, përgjithësimi të normës, imponimit të modelit biologjiko-mjekësor, del kështu si akoma më efikas e i zgjeruar se ai penal, megjithëse funksionimi i tyre është i ndërthurur. Natyra e krimit do të shpjegohet kështu me karakterin e kriminelit, karakteri me personalitetin e tij, personaliteti me historinë e tij personale dhe atë të mjedisit ku është rritur, përmes rrëfimit, pyetjeve dhe egzaminimit, historia e tij përmes situatës seksuale, etj. E njëjta skemë, me variacionet e nevojshme, do të përsëritet kudo, deri te dialoгу apo loja e lirë e asociacioneve « mes divanit dhe kolltukut » në kabinetin e psikanalistit ; kudo, e njëjta shtysë, e njëjta nxitje, madje i njëjti detyrim për t'u thënë, për t'u vetshqyrtuar, gërmuar, për t'u pohuar e rrëfyer, për t'u ofruar, pranuar e ndërtuar si identitet i caktuar.

Është e kotë të zgjatemi më tepër në logjikën e funksionimit të kësaj makine për prodhimin e vërtetësive dhe rrëfimeve, anët e ndryshme të së cilës Foucault i shpalos në libër

në mënyrë magjistrale, herë në një analizë, e herë në paraqitjen e një skene klasike, deri te pasojat masive *biopolitike*. Përmendja ironike e « rasteve » dhe anekdotave, nuk janë medoemos pasazhet më pak të thella të librit që keni në duar. Përpara se ta lemë lexuesin në kontaktin e drejtpërdrejtë me tekstin e librit, implikimet e të cilit janë pothuaj të pashtershme, gjë që e bën, paradoksalisht, librin njëherësh më të dendur dhe më të kuptueshëm të Foucault-së, na duhet të ndalemi paksa te raporti me *psikanalizën* dhe vendi i saj në libër.

Psikanaliza në dispozitivin e seksualitetit¹³

Mund të themi se hulumtimi i Foucault-së zhvillohet duke privilegjuar, herë veç e herë së bashku, tre drejtime, fusha apo lëme të qenies shoqërore : institucionet e mjekimit, ato që përcaktojnë ndarjen e madhe mes normales dhe patologjikes dhe format e ndryshme të « kurimit », apo marrjes nën kujdes (*care*) ; institucionet e dënimit, ato që përcaktojnë ndarjen e madhe mes së lejuarës dhe së palejuarës, mes normës dhe shkeljeve, dhe format e ndryshme të korrigjimit, ndëshkimit, ridrejtitimit, shtrimit, adaptimit ; institucionet e vërtetësimit (*véridiction*), rreth të cilave sillet dhe përcaktohet prodhimi i ligjërimeve me vlerë vërtetësie dhe efektet e kësaj të vërtete. Qarkullueshmëria e ndërsjellë e të treja këtyre zonave është e dukshme. Po aq është e dukshme përkatësia e psikanalizës në zemër të kësaj tresheje : ajo është sa teknikë e re e mjekimit dhe ripërkufizim i patologjisë mendore, sa riformulim i së lejuarës dhe së palejuarës për subjektin dhe horizont i mundshëm i « përshtatjes » së tij, aq dhe formulim i ekzistencës së një lloji të ri të vërtete dhe i një raporti të veçantë të subjektit me këtë të vërtetë : teknikë mjekimi, teknikë korrigjimi dhe dispozitiv vërtetësimi. Në mënyrë të pashmangshme pra, psikanaliza duhej të figuronte si një nga objektet e analizuar në libër. Madje, po të kemi parasysh se shtysa për të folur, për t'u vetërrëfyer, nxitja për të shprehur të vërtetën përmes ligjërimit, përballë një instance që duhet ta mbledhë, drejtojë dhe udhëzojë atë, po të mbajmë parasysh se ky këmbim fjalësh që synon prodhimin në akt të së vërtetës rrotullohet i tëri rreth statusit të dëshirës dhe zonës së seksualitetit, psikanaliza del si objekti qëndror i librit, si sendërtimi kulmor i vullnetit për dije rreth seksit. Te *Historia e çmendurisë*, psikanaliza paraqitet si një epokë e re dhe ardhja e Freud-it si inaugurimi i daljes së çmendurisë nga hapësira psikiatrike ku kishte mbetur e robëruar dhe e dënuar me heshtje, si

¹³ Raportet e Foucault-së me psikanalizën në përgjithësi dhe trajtimi i saj brenda kuadrit të dispozitivit të seksualitetit në veçanti (përfshirë, sidomos, dhe rolin e saj lidhur me politikën e identiteteve seksuale) janë shumë komplekse dhe nuk mund t'i analizojmë me hollësi në këtë paraethënie. Do të mjaftohemi këtu vetëm me disa drejtime kryesore dhe vija të trasha.

rishkrim i kufirit ndarës mes normales dhe patologjikes mendore (normalja lexohej si një rast i veçantë i jonormales), si ikje nga moralizmi i vjetër, etj. Te *Les mots et les choses*, psikanaliza (si dhe etnologjia, pra Lacan dhe Lévi-Strauss) zinte një vend të shqendërzuar në raport me sundimin e shkencave humane dhe kjo shmangie e bënte atë një pikëvrojtim kritik mbi këto shkenca, themelet dhe presupozimet e tyre. Tanimë, nga parim dhe pikënisje e hulumtimit, ajo bëhet objekt i studimit dhe shënjestër e tij, « si diçka e vdekur » thotë Jacques-Alain Miller¹⁴. Psikanaliza paraqitet këtu si pjesë, dhe ndoshta pjesa më qendrore, e « dispozitivit të seksualitetit ». « Historia e dispozitivit të seksualitetit shërben si një arkeogjenealogji e psikanalizës » vijon Miller. Dhe statusi që i jep Foucault psikanalizës, në këtë gjenealogji të zhbirimit kokëfortë të seksit në historinë moderne perëndimore, nuk është, sigurisht, shumë i pëlqyeshëm.

Kritikat kryesore të Foucault-së do të drejtohen, në forma të ndryshme, pikërisht ndaj atij tipari të psikanalizës që bën të mundur futjen e saj në zemër të dispozitivit të seksualitetit, domethënë, shtysës për t'u thënë, për vetërrëfime dhe për të prodhuar ligjërime vërtetësie, shkurt pra, disponimit të përgjithshëm për ta futur seksin (dhe prej aty, tërë faktin njerëzor) në ligjërim. Psikanaliza ndan kështu me dispozitivin e seksualitetit dhe me tërësinë e dijeve « psi- » të shekullit XIX të njëjtën kureshti të pangopur për ta gjurmuar dhe thënë faktin seksual në të tëra format e tij, dispozitë që ajo e shpie në maksimum duke e bërë formën themelore të ushtrimit të saj dhe duke i dhënë, haptas, vlerë epistemologjike dhe terapeutike. Aty ku dispozitivi klasik i seksualitetit e bënte këtë gjë disi fshehtas, ose « si nga e keqja », në emër të diçkaje tjetër (njohjes, parandalimit, shëndetit, etj.), psikanaliza e shndërron atë në parim pozitiv duke e instaluar në zemër të procedurës së subjektit për njohjen e vet. Po ashtu, psikanaliza rimerr disa nga vatrat e artikulimit të dispozitivit të seksualitetit, para së gjithash përqëndrimin të seksualiteti femënor (bosht qëndror i frojdizmit, që kushtëzon artikulimin e kompleksit të Edipit) dhe atë që Foucault e quan « histerizimi i trupit femëror ». Dhe në fakt, psikanaliza themelohet, të paktën në legjendën e saj të treguar nga Freud-i, rreth dy rasteve të

¹⁴ J.-A. Miller, « Michel Foucault et la psychanalyse », në *Michel Foucault, philosophe. Rencontre internationale*, Seuil, 1989. Shih, po ashtu, dhe debatin e Foucault-së me disa psikanalistë, ndër të cilët edhe Jacques-Alain Miller, pak pas botimit të librit dhe rreth tij : « Le jeu de Michel Foucault. Entretien sur *l'Histoire de la sexualité* », botuar fillimisht në *Ornicar. Bulletin périodique du champ freudien*, n° 10, korrik 1977, fq. 62-93 dhe rimarrë në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. III, fq. 298. J.-A. Miller, psikanalist i ardhur nga filozofia, mik i Foucault-së, është dhëndër dhe ekzekutuesi testamentar i Jacques Lacan-it, botuesi i veprës së tij postume dhe, në njëfarë mënyre, ruajtësi i ortodoksisë lakaniene. Duhet theksuar se në libër Foucault përmend shumë pak emra, dhe përta i përket psikanalizës figuron vetëm Freudi. Lacan asnjëherë. Megjithatë, për Foucault-në, duket se ajo që ai quan psikanalizë është në fakt një *continuum* frojdo-lakanian, perceptim gjerësisht i përhapur dhe pranuar në Francë, ku i fundit është shpalosës dhe teorizues më rigoroz i intuitave të të parit. Për më tepër që deviza e Lacanit ishte « Kthim te Freud ! ». Disa nga nëntekstet lakaniene u përpoqëm t'i vemë në pah me anë shënimesh përgjatë librit.

kurimit të një histerie femërore, rasti Anna O. dhe rasti Dora, gjë së cilës i duhet shtuar edhe eksperiencia teorike dhe praktike e Freud-it në Paris, teksa ndiqte leksionet publike të psikiatrit Charcot në spitalin Salpêtrière (të cilat do t'i përkthejë në gjermanisht) dhe prezantimin e rasteve histerike nga mjeshtri.

Grupi i dytë i kritikave, ka të bëjë me postulatit e psikanalizës i cili përqëndrohet te lidhja e dëshirës me Ligjin (ligj simbolik dhe ligj seksual njëkohësisht, i mishëruar nga Mbiuni dhe i formuluar-jetuar në formën e kastracionit). Sigurisht, psikanaliza nuk e rimerr « hipotezën shtypëse » në formën e vet naive. Madje, asaj ia detyrojmë mësimin se nuk ka gjendje paraprakisht të virgjër të dëshirës, dëshirë e egër që vetëm më pas do të qenkej bërë prë e shtypjes së pushtetit apo normave sociale. Psikanaliza (ajo e Freud-it dhe Lacan-it) mëson se Ligji është strukturues i dëshirës dhe formësues i subjektit, se kumti negativ i Ligjit nuk është katastrofë mbi dëshirën porse kushti i një seksualiteti njerëzor, i cili, si i tillë, duke qenë në raport thelbësor me ligjin simbolik (Edipin, kastracionin, dallimin mes sekseve) është thelbësisht i ndryshëm nga ai shtazor dhe nuk kufizohet te substrati biologjik. Por, raportimi i subjektit vetëm në raport me Ligjin, qoftë ai dhe strukturues, i përket, sipas Foucault-së, një forme të vjetër të analizës, një juridizmi atavik, të trashëguar nga epoka e pushteti sovran monarkik, e cila funksionon si alibi për të fshehur teknologjitë e reja të ushtrimit konkret të pushtetit, pushtet i cili vetëm marginalisht dhe taktikisht artikullohet ende në formën e ligjit. Ndërkohë që evolucioni i pushtetit na ka bërë të kalojmë nga *simbolika e gjakut te analitika e seksualitetit*, psikanaliza duket sikur merr përsipër ta rishkruajë rendin e ri seksual sipas gjuhës së vjetër të ligjit dhe simbolikës. Duket se, në këtë pikë, Foucault bën të tijat një pjesë të kritikave që i patën drejtuar psikanalizës Deleuze dhe Guattari katër vjet më parë, në librin e tyre me titullin domethënës *L'anti-Edipe. Capitalisme et schizophrénie* (« Anti-Edipi. Kapitalizëm dhe skizopofreni », bot. Minuit, Paris, 1972), elozhin e të cilit Foucault e ka bërë shpesh¹⁵. Negativizimi i dëshirës (si e lindur nga një mungesë : pamundësia e Edipit dhe kastracioni) dhe familializmi ekskluziv (instancat « babi » dhe « mami » si të vetmet pole referimi për subjektin dëshirues), ishin dy frontet e sulmit të *Anti-Edipit*. Përkundër këtyre tipareve, Deleuze dhe Guattari propozonin një konceptim pozitiv dhe prodhimtar të dëshirës : « Pavetëdija nuk është teatër, por uzinë. »

Mirëpo, dëshira po aq i duket Foucault-së një term i infektuar dhe pjesë e vetvetishme e dispozitivit të seksualitetit. E gjithë makineria e madhe e vetërrëfimeve në Perëndim është

¹⁵ Shih, për këtë, « Metoda gjenealogjike dhe dijet e nënshtruara. Leksion i 7 janarit në Collège de France », në M. Foucault, *Pushteti dhe dija. Katër sprova*, vep. cit., fq. 75.

vënë në punë pikërisht nisur nga postulati i dëshirës : dëshirë trazuese, dëshirë turbulluese, e pabindur, tinëzare, e lindur nga trupi dhe që synon të depërtojë e të ndohtë shpirtin, duke e shtyrë atë në mëkat, qoftë edhe pasiv. Krishterimi ishte i pari që e vuri në punë këtë makineri, dhe dispozitivi i seksualiteti i ka rrënjët e veta te teknika e konfesionalit, të udhëzimi e direktimi shpirtëror, te puna e bërë mbi veten nga besimtari për të gjurmuar çdo shenjë, sado të vogël, të dëshirës, çdo thirrje të maskuar të mishit, për të interpretuar çdo prirje, për të demaskuar çdo pëlqim. Dispozitivi i seksualitetit mbështetet te postulimi i njeriut si qenie e dëshirës dhe te postulimi i shprehjeve të dëshirës si veçanërisht të maskuara : e pra, objekt qëmtimi, tregimi, zbulimi e interpretimi pa fund. Një ekonomi e tërë e trupit dhe kënaqësive të tij zë vend, e cila e kodifikon më pas kënaqësinë rreth seksit dhe ligjeve të tij. Seksualizimi i kënaqësisë, ajo që do të mund ta quanim *fallocentrizmi* i kënaqësisë në Perëndim, është ana e pasme e postulatit të dëshirës. Në këtë gjenealogji kishtarë të « dëshirës » Foucault denoncon jo vetëm përkatësinë e psikanalizës brenda dispozitivit seksual, si një vazhdim i tij (aty ku ajo pretendonte për thyerje), por i bën një kritikë të tërthortë edhe orvatjeve dëlëziane për të gjetur rrugëdalje te një teori e re (një ontologji e re) e dëshirës.

Megjithatë, njëfarë sikleti vihet re në këtë sipërmarrje për një gjenealogji të psikanalizës. Kritika nuk është totale, dhe vihet re lehtë se psikanaliza është më pak e keqtrajtuar në libër sesa « shkencat » dhe dijet e tjera bashkëkohëse të saj. Ndryshe nga sa vë re J.-A. Miller tek artikulli i sipërcituar, statusi i psikanalizës është këtu i dyfishtë : ajo është sa në vazhdim, aq dhe heterogjene ndaj dijeve të tjera bashkëkohore, kundër të cilave i është dashur shpesh të ndërtohet e imponohet, dhe të cilat e luftojnë edhe sot (shih kundërvënien e Freud-it, por akoma dhe më të Lacan-it, ndaj pothuaj tërë psikologjisë e psikiatrisë së shekullit). Psikanaliza formon bashkë me to, sipas Foucault, një dispozitiv të caktuar, por gjithë duke ruajtur dhe kultivuar një veçanti radikale, që shpesh e bën të veprojë në kah të kundërt me dispozitivin në fjalë, si antidot i tij¹⁶. Tipari më i rëndësishëm, në këtë kuptim, është anti-biologjizmi thelbësor i psikanalizës, këmbëngulja e saj për ta « lexuar » njerëzoren,

¹⁶ Kështu, lidhur me kodifikimin seksual të kënaqësive dhe seksualitetin femënor, leximi i kujdeshëm i *Tre eseve mbi teorinë seksuale* të Freud-it (dhe jo « teorinë e seksualitetit ») shfaq po atë ambiguitet. Vërtet, çdo gjë në pamje të parë e fut atë në dispozitivin e seksualitetit. Por, nga ana tjetër, Freudi përshkruan aty pikërisht një proces të caktuar të *seksualizimit* të kënaqësive dhe ndërtimit të trupit seksual. *Fallocentrizmi i kënaqësisë*, në fund të fundit, del si një ideologji me efekte materiale, si proces i inkorporimit të një norme (qoftë dhe antropologjike). E analizuar në vetvete (dhe kjo është gjëja më e vështirë, koncepti më i errët) kënaqësia të shpie medoemos në deseksualizim, ose në neutralizimin e instancës unike të ligjit despotik të seksit (ashtu si mendimi, ligjërimi apo gjuha shpion në desubjektivim). Këtë deseksualizim të dëshirës, Freudi, me ose pa dashje, e merr parasysh kur e emërton fëmijën si « pervers polimorf ». Posa që shqyrton « faktin » anarkik të kënaqësisë, Freudi është i detyruar të postulojë një trup erotik paraprak, fillestar, përpara mpiksjes së tij në zona erogjene dhe « arbitraritetit » të tyre anatomik, hormonal, evolutiv, social, gjinor, etj.

jo vetëm psikiken por edhe seksualitetin, jo nga substrati biologjik i parë si fat dhe normë, por në raport me ligjin dhe dimensionin simbolik. Pikërisht arkaizmi i ligjit e bën psikanalizën t'i shpëtojë prirjes biologjizuese të tërë psikiatrisë së kohës, duke u bërë kështu pengesë, brenda mundësive të saj, ndaj zhvillimit të asaj që Foucault do ta quajë « racizmi shtetëror » : « Nderi politik i psikanalizës – ose, të paktën, i pjesës më koherente të saj – qëndron pikërisht te fakti se ajo, që në lindje të saj, domethënë, që nga çasti kur i ktheu shpinën neuro-psikiatrisë së shprishjes degjeneruese, e nuhati me mprehtësi dinamikën e pakthyeshme mësimëse të këtyre mekanizmave të rinj të pushtetit që pretendonin të kontrollonin dhe administronin përditshmërinë e seksualitetit : pa dyshim këtu qëndron dhe arsyeja e përpjekjes këmbëngulëse të Freud-it për t'i dhënë seksualitetit si parim ligjin – ligjin fisnor, ligjin e ndalimit të fëlligësishtisë në gjak, ligjin e Atit-Sovran, shkurt pra, përpjekja për të thirrur rreth realitetit të dëshirës gjithë rendin e pushtetit të vjetër, në kundërpërgjigje ndaj rritjes së racizmit bashkëkohës. Kjo e bëri psikanalizën të ishte gjithmonë – në thelb, dhe vetëm me ndonjë përjashtim të rrallë – në kundërshtim teorik dhe praktik me fashizmin. ¹⁷»

Shihet qartë pra, se statusi i psikanalizës brenda dispozitivit të seksualitetit, qoftë teorikisht, qoftë politikisht, është i dyfishtë. Ajo duket të jetë në një *familjaritet të kithët* me dispozitivin në fjalë : sa pjesë qëndrore e tij, aq dhe në shmangie të përhershme ndaj postulateve dhe dinamikës së brendshme të sistemit.

Ky status i zhvendosur i psikanalizës, që turbullon disi tablonë e ndërtuar nga Foucault, vjen nga veçantia e saj në fushën e dijes : psikanaliza është e vetmja nga disiplinat që indentifikohet pothuaj e tëra me emrin e themeluesit të saj ; në fund të fundit, përkufizimi më i thjeshtë i psikanalizës është : disiplina e shpikur nga Sigmund Freud-i. Lidhja thelbësore me një emër të përveçëm e bën sigurisht problematik statusin e saj si shkencë (nëse pranojmë se shkenca, në universalitetin e saj abstrakt dhe verifikueshmërinë e pohimeve të veta nuk e njeh autoritetin e emrit të përveçëm), por po aq e bën problematike futjen e saj *pa mbetje* brenda një dispozitivi të dhënë, brenda « mërmërimës anonime të ligjërimeve ». Fshirja e instancës së autorit ishte një nga efektet kryesore të metodës arkeo-gjenealogjike të Foucault-së¹⁸. Por, në rastin e psikanalizës, metoda has në një kockë të patretshme krejtësisht, ngaqë

¹⁷ Shih, këtu më poshtë, Kapitulli V, « E drejta e vdekjes dhe pushteti mbi jetën ».

¹⁸ Dekonstruktimi i « monarkisë së autorit » është një motiv i përhershëm i Foucault-së, i teorizuar në tekste të veçanta dhe i praktikuar në raportin e tij me tekstet dhe arkivat, deri edhe në raportin e tij, si 'autor' me tekstin e vet. Gjurmët janë të shumta, por le të përmendim, në frëngjisht, konferencën e famshme të mbajtur më 22 shkurt 1969 përpara 'Société française de philosophie' me titull « Qu'est-ce qu'un auteur ? » (botuar fillimisht në *Bulletin de la Société française de philosophie*, 1969 dhe rimarrë në *Dits et écrits*, vep. cit., vëll. I, fq. 789). Në shqip, mund të shihet Leksioni përurues në Collège de France, « Rendi i ligjërimit », sidomos hapja e tij, dhe

autorësia « transhendentale » e Freudit lidhur me korpusin teoriko-praktik të psikanalizës është jo rastësore, jo një moment i tij, por kushtetuese e korpusit si të tillë. Status të cilin Foucault e kishte identifikuar tashmë si të tillë, disa vite më parë, teksa, në një konferencë me titull « Nietzsche, Freud, Marx » (1964), pra kushtuar tre emrave të përveçëm, i cilëson ata të tre me shprehjen « *fondateurs de discursivités* », si ngjarje pra, që hapin një hapësirë të re ligjërimore (ose, më saktë, ‘ligjërimësie’, nëse mund të themi), që hapin fushën dhe mundësinë e një shpërndarjeje të re të shenjave, domethënieve, leximeve e interpretimeve, të një raportit të ri mes ‘fjalëve dhe qenieve’. Për këtë arsye, Nietzsche kryesisht, por edhe Marxi dhe Freudi janë të « pagjenealogjizueshëm », ngase janë pikënisje për hulumtimet gjenealogjike dhe zhytja e tyre në korpuse ligjërimore më të gjerë dhe përfshirës (epoka, kushtet, mjedisi, dispozitivë të caktuar, etj.) është përherë e pjesshme. Pikërisht, ky heterogjeneitet intim i psikanalizës me mjedisin e saj të shfaqjes (dispozitivin e seksualitetit dhe mjekësinë e psikiatrinë e shekullit XIX) do të bëjë që, në rastin e këtushëm, kufijtë e mirëpërcaktuar kohorë të dispozitivit të seksualitetit të thërmohen. Fillimisht, *Historia e seksualitetit* u lajmërua si një projekt me gjashtë vëllime, të cilët, pas *Vullnetit për dije* si hyrje e përgjithshme, duhet t’i kushtoheshin secili studimit konkret të një zone të caktuar të dispozitivit në fjalë: seksualitetit të fëmijëve, anormalëve, histerizimit të trupit femëror, teorive eugjeniste, etj. Por, me kohë, sa më shumë që projekti afirmohej si gjenealogji e psikanalizës dhe e nxitjes për ta shprehur seksin në ligjërimet vërtetësie, aq më shumë sprapsen kufijtë kohorë të hulumtimit, gjë që e detyron Foucault-në të dalë nga zona familjare e studimeve të veta (Perëndimi i shekujve XVII-XIX) për të zbritur deri te Etërit e Kishës në shekujt e parë të krishterimit dhe, më pas, deri te kultura greko-latine, ku synon të zbulojë fillesat, në kulturën perëndimore, të asaj që ai e quan « problematizimi moral i kënaqësive ». Mirëpo, ndërkohë, peizazhi ka ndryshuar. Nuk kemi të bëjmë më me futjen e seksit në ligjërim dhe gjurmimin e tij të pandalur (gjë që do ta bëjë krishterimi i hershëm duke rimarrë dhe rikodifikuar trashëgimin greko-latin), por me një konfigurim tjetër, ku njeriu, përmes problematizimit (moral, shëndetësor, dietetik, erotik, ekonomik, etj.) të kënaqësive të tij, e merr veten (*soi*) si objekt të interesit, merakut, kontrollit, mbikëqyrjes dhe kultivimit. Ky raport i drejtpërdrejtë me veten dhe praktikën e saj, që nuk ndërmjetësohet nga instanca e pushtetit, është vatra e prodhimit të asaj që Foucault do ta cilësojë si « substancë etike ». Gjenealogjia e seksualitetit dhe psikanalizës përkulet kështu në një « gjenealogji të etikës » dhe të teknologjive lindjes së subjektit si raport intensiv me veten (*souci de soi*). Vëllimi 2

parathënia jonë, « Michel Foucault. Një praktikë e teorisë », të dy në, Michel Foucault, *Pushteti dhe dija. Katër prova*, vep. cit., përkatësisht fq. 25-66 dhe fq. 9-19.

dhe 3 i *Historisë së seksualitetit*, do të botohen pak para vdekjes së parakohshme të autorit (1984), dhe i kushtohen kësaj teme. Një vëllim i fundit, që i kushtohet rikodifikimit të etikës antike në universin e krishterimit, mbeti i papërfunduar dhe pra, në pajtim me vullnetin e autorit, i pabotuar.

*

* *

Kontekstualizimi në vija shumë të trasha, që u orvatëm të përvijonim deri këtu, mbetet, jam mëse i vetëdijshëm, mjaft i mangët, por ishte i detyruar nga mosnjohja e mjaftueshme e autorit në mjedisin shqiptar dhe nga kufijtë e ngushtë të një parathënieje. Analiza e hollësishme e librit do të kërkonte një libër të tërë tjetër, dhe madje shumë më voluminoz se i pari. Me dashje, për shembull, nuk u cek formulimi i *biopolitikës* në kapitullin e fundit të librit, tematikë që e hedh atë drejt një problematike krejt të re dhe e cila, që nga studimet postkoloniale deri te teorizimet e Antonio Negrit apo Giorgio Agambenit, është pafundësisht e diskutuar sot në dhjetëra departamente, kongrese, revista, botime etj. Ashtu si psikanaliza në dispozitivin e seksualitetit, *Vullneti për dije*, më shumë se gjithë të tjerët, është një libër në zhvendosje të përhershme në veprën e Foucault-së : një udhëkryq programatik pistash e propozimesh teorike, një libër-kreshtë, nga ku shikimi mund të shkojë në dhjetëra drejtime, një vatër konceptuale ku reflektohet dhe përthyeret tërë puna kërkimore e autorit, para dhe pas tij, ku vijnë e (zh)vendosen të tëra profilet e njëpasnjëshme të përmendura më sipër. Është libri më i *populluar* i Foucault-së, jo vetëm me ide e koncepte, por dhe skena, ligjërime, taktika, strategji, vegla dhe personazhe konceptuale ; libri më i populluar i një autori, sipërmarrjen dhe etikën teorike të të cilit mund ta përkufizojmë si *popullim të përhershëm të mendimit me figura të reja*. Është, po ashtu, libri më i lexueshëm dhe më i *lexuar* i tij, libri me leximet më të larmishme (nga analiza e biopushtetit te luftërat e identiteve seksuale, nga studimet post-koloniale tek ato feministe, gjinore e *queer*, nga historia e psikiatrisë tek analiza e socializmit, etj.) Është, së fundi, një model i prozës eseistike, libri më i dendur me gjeste teorike, libri ku shpaloset më së miri mjeshtëria e autorit për *dramatizmin* e teorisë, aftësia e tij për t'u futur në palat e ligjërimeve dhe për të teorizuar duke (u) ngritur (atyre) kurthe të shumanshme, duke e bërë kësisoj praktikën e mendimit një përvojë të çlirimit

nga pesha e së dhënës dhe të emancipimit nga identifikimet tinëzare, kinse evidente, të kohës. Kështu që, tani, mund ta pohojmë se pyetja jonë në fillim të këtij teksti, teksa kërkonim të gjenim se cili, nga librat e Foucault-së, ishte më përfaqësuesi, nuk ishte gjë tjetër veçse inskenimi i një *suspensi* të paqenë, një mënyrë fiktive për të nisur një tekst, përpjekje e mjerë (dhe homazh i vockël ndaj autorit) për të dramatizuar disi paraqitjen e librit. Dramatizimi i vërtetë fillon këtu më poshtë, me fiksjonin e parë, të cilin tregimtari skeptik na e jep, sigurisht, në një kushtore ironike (që, në shqip, bëhet habitore) : « Prej kohësh paskemi jetuar, dhe mesa duket jetokemi akoma, nën peshën e një regjimi viktorian. Namuzi perandorak, na thonë, paskësh hedhur vellon e heshtur dhe hipokrite mbi fushën e seksualitetit. » Dhe pastaj vazhdon historia... Emancipim të mbarë !